



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:233578
Datë: 20.03.2024
Numri i dokumentit: 05477728

PPP.nr.220/22

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - gjyqtari Faton Ajvazi, me sekretaren juridike Makfire Reçica, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Kompania e Sigurimeve “I.“ sh.a, me seli në Prishtinë, bulevardi “...”, nr...., kundër debitorit Sh.S. nga Ferizajt, rr “...”, për pagesën e borgjit, duke vendosur për prapësimin e ushtruar nga debitori, më datë 20.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I.PRANOHET pjesërisht prapësimi i debitorit Sh.S., i ushtruar kundër urdhrorit për përmbartim me numër P.nr.352/22, të datës 19.10.2022, i lëshuar nga Përmbartuesi Privat K.M. nga Prishtinë, sa i përket shumës së borxhit prej 234.16 euro, që rrjedh nga faturat: F-..., e datës 01.12.2021, F-..., e datës 05.01.2022, F-..., e datës 01.02.2022, F-..., e datës 01.03.2022, F-..., e datës 01.04.2022, F-..., e datës 04.05.2022, F-..., e datës 01.06.2022, F-..., e datës 01.07.2022 dhe F-..., e datës 01.08.2022, dhe **SHFUQIZOHET** dhe lihet jashtë fuqisë juridike urdhri për lejimin e përmbartimit P.nr.378/21, i datës 11.10.2021 për shumën e borxhit prej **234.16 euro**, kurse **REFUZOHET** si i pabazuar prapësimi i debitorit Sh.S., i ushtruar kundër urdhrorit për përmbartim P.nr.352/22, të datës 19.10.2020, sa i përket shumës së borxhit prej 29,27 euro, që rrjedh nga fatura F-..., e datës 08.09.2021 dhe për shpenzimet e përmbartimit dhe **MBETET NË FUQI** urdhri për përmbartim vetëm për shumën e borxhit prej **29,27 euro** dhe për shpenzimet e përmbartimit në pajtim me Udhëzimin Administrativ për Tarifat e përmbartuesve privat.

II.UDHËZOHET kreditori Kompania e Sigurimeve “I.“ sh.a, që kërkesën ndaj debitorit sa i përket shumës së borxhit prej 234.16 euro, ta realizoj në procedurën kontestimore, përmes padisë në gjykatën kompetente.

A r s y e t i m

Me urdhrin P.nr.352/22, të datës 19.10.2022, Përmbaruesi Privat K.M., e ka caktuar përmbarimin e propozuar nga kreditori Kompania e Sigurimeve "I." sh.a, kundër debitorit Sh.S., për detyrimin e debitorit, për pagesën e borxhit në shumë të përgjithshme prej 263.43 euro, duke u bazuar në faturat : F-..., e datës 01.12.2021, F-..., e datës 05.01.2022, F-..., e datës 01.02.2022, F-..., e datës 01.03.2022, F-..., e datës 01.04.2022, F-..., e datës 04.05.2022, F-..., e datës 01.06.2022, F-..., e datës 01.07.2022 dhe F-..., e datës 01.08.2022, si dhe pagesën e shpenzimeve të procedurës përmbarimore, ose bllokimin e të gjitha llogarive nëpër të gjitha bankat komerciale në emër të debitorit, sekuestrimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit, të përmbaruesit privat, debitori, brenda afatit ligjor, ka ushtruar prapësim, duke i propozuar gjykatës që ta aprovoj prapësimin si të bazuar.

Kreditori ka ushtruar përgjigje me shkrim në prapësimin e debitorit, me të cilën i ka propozuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin si të pabazuar dhe të mbetet në fuqi urdhri për përmbarim.

Gjykata i shqyrtoj shkresat e lëndës, urdhrin për përmbarim P.nr.352/22, të datës 19.10.2022 dhe pretendimet në prapësim të debitorit dhe vlerësoj se:

Prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar.

Gjykata me rastin e rishikimit të procedurës përmbarimore bazë të nënti 43, par 4, të LPP-së, gjeti se urdhri për përmbarim i atakuar me prapësim nga debitori në këtë rast është pjesërisht i ligjshëm, respektivisht është i ligjshëm sa i përket shumës së borxhit prej 29.27 euro, që rrjedh nga fatura F-..., e datës 08.09.2021, dhe për shpenzimet e përmbarimit në pajtim me Udhëzimin Administrativ për Tarifat e përmbaruesve privat, ndërsa nuk është i ligjshëm urdhri për përmbarim në fjalë sa i përket shumës së mjeteve prej 234.16 euro, që rrjedh nga faturat: F-..., e datës 01.12.2021, F-..., e datës 05.01.2022, F-..., e datës 01.02.2022, F-..., e datës 01.03.2022, F-..., e datës 01.04.2022, F-..., e datës 04.05.2022, F-..., e datës 01.06.2022, F-..., e datës 01.07.2022 dhe F-..., e datës 01.08.2022.

Gjykata me rastin e shqyrtimit të pretendimeve të debitorit në prapësim, gjeti se faturat: F-..., e datës 01.12.2021, F-..., e datës 05.01.2022, F-..., e datës 01.02.2022, F-..., e datës 01.03.2022, F-..., e datës 01.04.2022, F-..., e datës 04.05.2022, F-..., e datës 01.06.2022, F-..., e datës 01.07.2022 dhe F-..., e datës 01.08.2022, që kapin shumën e borxhit prej 234.16 euro, në bazë të cilave është nxjerrë urdhri për përmbarim i kundërshtuar me prapësim, nuk i plotësojnë

kushtet ligjore të kërkuara nga neni 29, par 1, nën par 1.3, të LPP-së, për tu cilësuar si dokumente të besueshme. Në rastin konkret kemi të bëjmë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe normës materialo juridike të dispozitës së nenit 29, par 1, nën par 1.3, të Ligjit për Procedurën Përmbartimore, ngase përmbartuesi privat K.M., sa i përket faturave të cekura, gabimisht ka vlerësuar se faturat në fjalë janë dokumente të besueshme dhe të përshtatshme për përmbartim, sepse faturat në fjalë siç shihen nuk janë të nënshkruara nga debitori dhe as të vulosura nga debitori.

Mbi bazën e të dhënave të theksuara më lartë rezulton se faturat kontestuese nuk përmbajnë elementet detyruese për t'u cilësuar si fatura të rregullta. Duke qenë se është caktuar përmbartimi në mungesë të dokumentacionit përcjellës të rregullt e nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, gjegjësisht nga Polica NR. SH-..., e datës 08.09.2021, në bazë të cilës janë lëshuar faturat e cekura, nuk mund të cilësohen faturat në fjalë si dokumente të besueshme, për faktin se faturat në fjalë dhe Polica e cekur eventualisht mund të përdoren si provë vetëm në procedurën kontestimore por jo edhe në procedurën përmbartimore për çka edhe Gjykata e udhëzoi kreditorin si në pikën II të dispozitivit të aktvendimit. Andaj, në bazë të fakteve të cekura më lart është e pamundur të konstatohet nëse faturat dhe polica të përmendura më lart paraqesin dokumente të besueshme.

Gjykata, sa i përket pjesës, gjegjësisht pikës I të dispozitivit të këtij aktvendimi, ku e ka pranuar prapësimin e debitorit sa i përket shumës së borxhit prej 29,27 euro, që rrjedh nga fatura F-..., e datës 08.09.2021, dhe për shpenzimet e përmbartimit, gjeti se fatura e cekur më lart, konsiderohet dokument i besueshëm dhe në pajtim me nenin 29, par 1, nën par 1.3, të LPP-së, për arsye se siç konstatohet e njëjta është e nënshkruar nga debitori dhe kreditori.

Gjykata, sa i përket faktit se në faturën e datës 08.09.2021, të cilën e konsideroj si dokument të besueshëm në pajtim me nenin 29, par 1, nën par 1.3, të LPP-së, se në të është shënuar edhe tabela me faturat tjera, për të cilat u konstatua se të njëjta nuk i plotësojnë kushtet ligjore nga neni 29, par 1, nën par 1.3, të LPP-së, erdhi në konstatimin se ky fakt nuk mund të konsiderohet si pranimit i faturave tjera nga debitori përveç faturës së datës 08.09.2021, të cilën e ka nënshkruar debitori. Për më tepër në tabelën e cila figuron në faturën e cekur, përveç shumëve prej 29,27 euro, nuk figuron numri i faturave e as data e lëshimit të faturave.

Nga të cekurat më lart dhe në bazë të nenit 73, par 1, 2 dhe 3, të LPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

PPP.nr.220/22, më datë 20.03.2024

GJYQTARI
Faton Ajvazi

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në afatin prej 7 ditësh, nga dita e pranimet të këtij aktvendimi.